

## **LICENCË PËR SHPËRNDARJEN E NGROHJES QENDRORE (ME KUSHTE)**

**DHËNË:**

***"NGROHTORES SË QYTETIT TERMOKOS" SH.A.***

Numri i Regjistrimit:  
ZRRE\_Li\_11/06

## PASQYRA E PËRMBAJTJES

<b>PJESA I TERMAT E LICENCËS .....</b>	<b>3</b>
<b>PJESA II KUSHTET E LICENCËS.....</b>	<b>4</b>
Neni 1: Përkufizimet dhe Interpretimet.....	4
Neni 2: Llogaritë e Ndara për Biznesin e Shpërndarjes .....	6
Neni 3: Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve .....	7
Neni 4: Përputhshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit , Kodin e Matjes dhe me Rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji .....	7
Neni 5: Detyrimet e të Licencuarit Lidhur me Pajisjet Matëse .....	8
Neni 6: Kycja në Rrjetin e Shpërndarjes së Ngrohjes .....	8
Neni 7: Qasja dhe Shfrytëzimi i Rrjetit të Shpërndarjes së Ngrohjes .....	9
Neni 8: Plani Zhvillimor.....	9
Neni 9: Blerja Ekonomike e Aseteve dhe Shërbimeve .....	10
Neni 10: Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve Relevante .....	10
Neni 11: Shfrytëzimi Shtesë ose Tjetërsimi i Aseteve Relevante .....	11
Neni 12: Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit .....	11
Neni 13: Standardet e Përbushjes së Biznesit të Operimit të Sistemit të Shpërndarjes	
Neni 14: Qasja në Tokë dhe /ose Ndërtesë.....	13
Neni 15: Kufizimi në Përdorimin e Informacionit Përkatës.....	13
Neni 16: Sigurimi i Informacioneve për Operatorët e tjerë të Sistemit të Shpërndarjes .	
Neni 17: Kodi i Sjelljes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.....	14
Neni 18: Shëndeti dhe Siguria.....	14
Neni 19: Puna .....	14
Neni 20: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit.....	15
Neni 21: Shërbimet Publike të Detyrueshme .....	15
Neni 22: Sigurimi i Informacioneve ZRRE-së.....	15
Neni 23: Arsyet për Përfundimin, Tërheqjen dhe Modifikimin e Licencës .....	16
Neni 24: Masat dhe Gjobat Administrative .....	17
Neni 25: Zgjidhja e Kontesteve.....	17

**Shtojca 1** – Përshkrimi i karakteristikave të sistemit

**Shtojca 2** – Propozimet për standardet e përbushjes për furnizimin e konsumatorëve

**Shtojca 3** – Informacione pronësie të elementeve të sistemit

## PJESA I      TERMAT E LICENCËS

1. **Zyra e Rregullatorit të Energjisë (tani e tutje "ZRRE ")**, gjatë ushtrimit të autoritetit të dhënë prej Neneve 15.2 (a), Nenit 28.2 (h) dhe Nenit 37 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe Nenit 16.2 të Ligjit mbi Energjinë, Neneve 5.2 dhe 5.3 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore dhe Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, me anë të kësaj, i lëshon: **Ngrohtores së Qytetit "TERMOKOS" SH.A** (tani e tutje duke iu referuar si i "licencuari"), këtë licencë për **kryerjen e Shpërndarjes së energjisë termike** gjatë periudhës së specifikuar në paragrafin 6, sipas Neneve dhe Kushteve të përcaktuar në Pjesën II (tani e tutje duke iu referuar si "Kushtet").
2. Territori që mbulon kjo licencë, e në përputhje me Nenin 32, paragrafi 2 i Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, është territori i Prishtinës (tani e tutje : "Territori").
3. I Licencuari do të vepron në pajtim me kriteret e të gjithë legjislacioneve të aplikueshëm, Neneve dhe Kushteve të kësaj licence , dhe duke bërë këtë, do të përpiqet që në çdo kohë të vepron në pajtim me objektivat vijues të aplikueshëm:
  - a) kryerjen efektive të detyrimeve që i janë vendosur të Licencuarit nga kjo licencë;
  - b) operimin efikas, ekonomik dhe të koordinuar të rrjetit të shpërndarjes së ngrohjes nga ana e të Licencuarit;
  - c) promovimin e konkurrencës efektive në gjenerimin dhe furnizimin e energjisë termike, dhe (për aq sa është e qëndrueshme) promovimin e kësaj konkurrence për shitjen dhe blerjen e energjisë termike;
4. I Licencuari do të ofrojë shërbimet vijuese për territorin e përcaktuar që mbulohet prej tij:
  - a) Menaxhimin e sistemit të shpërndarjes;
  - b) Mirëmbajtjen e vendit dhe objektit në përputhje me kriteret teknike;
  - c) Harmonizimin e projekteve të veta me projektet zhvilluese ekonomike;
  - d) Parashikimin e kërkesave të territorit të mbuluar;
  - e) Transportimin e vazhdueshëm dhe të sigurt të energjisë termike përmes sistemit të shpërndarjes;
  - f) T'u japë shfrytëzuesve të rrjetit informacionet e nevojshme për qasjen efikase në sistem; dhe
  - g) Shërbime të tjera përkatëse.
5. Nenet dhe Kushtet e kësaj licence i nënshtrohen modifikimit ose përfundimit, ose tërheqjes në përputhje me afatet e tyre dhe me Nenet 35, 36, 37 dhe 39 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
6. Kjo licencë do të hyjë në fuqi më 04 Tetor 2006 dhe, përveç në rast se tërhiqet do të mbetet në fuqi në plotë dhe efektive, deri më 04 Tetor 2021 me mundësi vazhdimi sipas Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Vulosur me vulën e rëndomtë të ZRRE-së, më \_\_\_\_\_ .

Nënshkruar (në emër të Bordit të ZRRE-së) \_\_\_\_\_

## **PJESA II KUSHTET E LICENCËS**

### **Neni 1: Përkufizimet dhe Interpretimet**

1. Për qëllimet e kësaj licence, termat dhe shprehjet e renditura më poshtë, do të kenë kuptimin vijues:

**"Anëtar"** nënkupton në marrëdhënie të drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo Kompani Aksionare apo vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës të një Kompanie Aksionare të të Licencuarit, në secilin rast brenda kuptimit të legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë;

**"Konsumator"** ka kuptimin e dhënë në Nenin 3.1 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore

**"Pika shpërndarëse"** është nënstacioni termik prej të cilit i dërgohet shfrytëzuesit përfundimtar ngrohja dhe mundësisht edhe uji i ngrohtë sanitar për përdorim shtëpiak, dhe ku ngrohja matet me aparatura matëse të përshtatshme;

**"Plani zhvillimor"** është një plan zhvillimi që do të përgatitet nga i Licencuari sipas Nenit 8 të Ligjit mbi Energjinë;

**"Gypat e ngrohjes qendrore"** është një segment i rrjetit të furnizuesit që lidh direkt ndërtesën e prodhuesit me atë të konsumatorit;

**"Kodi i Shpërndarjes "** ka kuptimin e dhënë në Nenin 3.1 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore

**"Sistemi i Shpërndarjes"** ka kuptimin e dhënë në Nenin 3 të Ligjit për Energjinë

**"Shpërndarja"** ka kuptimin e dhënë në Nenin 3.1 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore

**"Operatori i Sistemit të Shpërndarjes"** ka kuptimin e dhënë në Nenin 3.1 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore

**"Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit"** është dokumenti me po këtë titull që duhet të përgatitet nga i licencuari sipas kushteve të kësaj licence.

**"Konsumator i privilegjuar (kualifikuar)"** është konsumatori i cili është ilirë të blejë energji termike prej furnizuesit të cilin e zgjedh vetë;

**"Konsumator përfundimtar"** është konsumatori që blen energji termike për ta shfrytëzuar vetë;

**"Viti Financiar"** është periudha e raportimit të të Licencuarit për qëllime Rregullative dhe zakonisht përfshin periudhën prej 15 Tetor të vitit aktual deri me 14 Tetor të vitit të ardhshëm, përveç nëse specifikohet ndryshe me legjislacionin sekondar relevant të nxjerrë nga ZRRE-ja.

**"Rrjeti i shpërndarjes së ngrohjes"** është sistemi i tubacioneve që transporton ngrohjen prej prodhuesit tek konsumatori;

**“Ngrohje apo Energji Termike”** ka kuptimin e dhënë në Nenin 3.1 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore

**“Ndërmarrje e ngrohjes”** ka kuptimin e dhënë në Nenin 3.1 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore

**“Sistemi i ngrohjes”** është sistemi i integruar dhe i kyçur i gjenerimit, shpërndarjes dhe furnizimit;

**“Legjislacion”** është ligji mbi Energjinë (2004/8), Ligji mbi Rregullatorin e Energjisë (2004/9), Ligji mbi Ngrohjen Qendrore (2005/02/ L-49) dhe ndonjë legjislacion tjetër që ka të bëjë me ngrohjen, legjislacion primar apo sekondar që do të nxirret për të ekzekutuar legjislacionin primar e që do të rregulloj sektorin e ngrohjes;

**“Kodi i Matjes”** ka kuptimin e dhënë në Nenin 3.1 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore

**“Pajisjet matëse”** ka kuptimin e dhënë në Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore

**“Modifikim”** përfshinë shtimin, përmirësimin dhe shprehjet e ndërlidhura që do të ndërtohen në përputhje.

**“Furnizues”** është personi i licencuar për furnizimin e ngrohjes qendrore;

**“Furnizim”** është shpërndarja dhe shtija ose rishitja e energjisë termike ndaj konsumatorëve

2. Termat e përdorur në këtë Licencë do të kenë të njëjtat kuptime si termat e përdorur në Legjislacion.
3. Duke iu referuar paragrafit 2, do të aplikohet çdo modifikim ose çdo ri-dekretim i legjislacionit që bëhet pas datës kur hyn në fuqi kjo licencë.
4. Përveçse nëse specifikohet ndryshe:
  - a) çdo referim ndaj një Neni me numër ose Shtojce me numër, është përkatësisht referim ndaj Nenit ose Shtojcës që mban të njëjtin numër në këtë licencë;
  - b) çdo referim ndaj një paragrafi me numër është referim ndaj paragrafit që mban të njëjtin numër në Neni ose Shtojcën ku bëhet referimi.
5. Subjekti ose titulli i ndonjë Pjese, Neni, Shtojce ose paragrafi nuk do të ndikojë përbërjen e kësaj të fundit.
6. Nëse të Licencuarit i vendoset një detyrim me një afat përfundimtar specifik në lidhje me kryerjen e detyrave, ai detyrim do të vazhdojë të jetë detyrues dhe në fuqi edhe pas atij afati kohor, pa paragjykim ndaj të gjitha të drejtave dhe masave administrative që mund t’i vendosen të licencuarit nëse ky i fundit nuk arrin të kryejë detyrën brenda afatit kohor.

7. Dispozitat e paragrafit 6 do të aplikohen në rast të çdo dokumenti, udhëzimi ose njoftimi që do të dorëzohet, ose edhe shërbimi që do të kryhet në përputhje me këtë licencë dhe me udhëzimet e nxjerra nga ZRRE-ja.

## **Neni 2: Llogaritë e Ndara për Biznesin e Shpërndarjes**

### **Kushti 1**

Në pajtim me Nenin 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë i Licencuari duhet të veproj në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e këtij Neni brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e lëshimit të kësaj licence.

1. I Licencuari do të përgatisë kontabilitetet / deklaratë vjetore rregullative në përputhje me Udhëzimin e Përkohshëm për Raportimin ndaj Rregullatorit, nxjerrë nga ZRRE-ja, dhe do t'i dorëzojë ZRRE-së një kopje të kontabilitetit / deklaratës vjetor të audituar, sipas orarit kohor / legjislacionit sekondar relevant të nxjerrë nga ZRRE-ja.
2. I Licencuari në kontabilitetin e vet të brendshëm do të mbajë llogari/kontabilitetin e ndarë për biznesin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si i tërë, si dhe llogari të ndara për ndonjë aktivitetet tjetër të licencuar që ka të bëjnë me ngrohjen, aktivitet tjetër të licencuar lidhur me energjinë si dhe aktivitet tjetër që nuk ka të bëjë me ngrohje, e në përputhje me Nenin 6.3 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore. Kur të kërkohet herë-pas-herë prej ZRRE-së, i Licencuari duhet të dorëzojë të gjitha llogaritë e tilla në ZRRE në formën dhe datën e specifikuar nga kjo e fundit. Këto llogari do të jenë në përputhje me Udhëzimin e Përkohshëm për Raportimin ndaj Rregullatorit, siç mund të nxirret nga ZRRE-ja kohë pas kohe.
3. Udhëzimi i Përkohshëm për Raportimin ndaj Rregullatorit ose udhëzimet që ZRRE-ja i ka njoftuar të Licencuarit sipas paragrafit 2, mes të tjerash mund të:
  - a) Specifikojnë formën e deklaratave/regjistrave të kontabilitetit për rregullatorin, përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm nga llogaritë e përfitimit dhe humbjes, bilancet, fitimet e njohura dhe deklaratat e humbjeve, deklaratat e rrjedhjes së parave të gatshme dhe deklaratat e sasive të të ardhurave vjetore, kostove, aseteve, borxheve, rezervave, ose furnizimet që, ose janë ngarkuar nga një biznes tjetër, ose i janë ngarkuar këtij të fundit, ose janë përcaktuar nga alokimi dhe ndarja midis biznesit të konsoliduar të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe ndonjë biznesi tjetër.
  - b) Specifikojë natyrën dhe përmbajtjen e deklaratave/regjistrave të kontabilitetit për rregullatorin, përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, kostove, aseteve ose borxheve dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, kostot, asetet dhe borxhet që i atribuohen aktiviteteve të specifikuara.
  - c) Specifikojë parimet e kontabilitetit për rregullatorin (përfshirë bazën për alokimin e kostove).

4. Për sa i përket deklaratave të kontabilitetit për rregullatorin për sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk do të ndryshojë bazat e tarifave, shpërndarjen ose caktimin e tarifave të aplikuara në lidhje me vitin financiar paraprak, përveçse në rast se ZRRE-ja ka nxjerrë udhëzime për qëllimet e këtij Neni të cilat e udhëzojnë të Licencuarin të ndryshojë këto baza, ose nëse ZRRE-ja ka dhënë aprovim paraprak me shkrim për ndryshimin në fjalë.
5. I Licencuari do veproj në pajtim me çdo udhëzim të nxjerrë nga ZRRE-ja e për qëllim të këtij Neni.

### **Neni 3: Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve**

I Licencuari do të sigurojë që biznesi i Shpërndarjes nuk do të jap dhe as nuk do të marrë asnjë subvencion ose ndër-subvencion (direkt ose indirekt) nga asnjë biznes tjetër i të Licencuarit ose nga ndonjë Anëtar (Ortaku) apo sipërmarrje tjetër e të Licencuarit dhe/ose nga ndonjë person tjetër.

### **Neni 4: Përputhshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit, Kodin e Matjes dhe me Rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji**

#### **Kushti 2**

Në pajtim me Nenin 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, pas konsultimeve me të Licencuarit tjerë relevant, ZRRE-ja mund të jap të Licencuarit udhëzim me një orar kohorë për të implementuar këtë Nen. Udhëzimi i tillë kohor mund të zbatohet dhe të ketë shtrirje në ato pjesë të Kodeve siç precizohet në atë orar.

1. I Licencuari do të përgatis draft Kodin e Matjes dhe draft Kodin e Shpërndarjes dhe do të dërgoj ZRRE-së për miratim, ashtu si precizohet në Ligjin për Ngrohje Qendrore. Pasi të miratohen këto Kode nga ZRRE-ja ato nuk mund të ndryshohen pa pëlqim me shkrim të lëshuar nga ZRRE-ja.
2. I Licencuari do të jetë përgjegjës për menaxhimin e çdo propozimi për ndryshimin e Kodit të Shpërndarjes apo Kodit Matës dhe dërgimin e propozimeve të tilla për ndryshim ZRRE-së për aprovim.
3. Kodin e Shpërndarjes dhe Kodit Matës që janë bërë të aplikueshëm I Licencuari do të publikoj në faqen elektronike të tij në formën që ato të shkarkohen dhe kopjohen lehtë dhe do të jetë përgjegjës që çdo kërkesë të çdo personi të interesuar të japi kopje të me çmim të arsyeshëm i cili do të mbulojë shpenzimet e të Licencuarit lidhur me nxjerrjen dhe kopjimin e ati Kodi. Çmimi i tillë do të aprovohet nga i Licencuari dhe kohë pas kohe do të publikohet në faqen elektronike të tij.
4. I Licencuari do të veproj në përputhje me dispozitat e Kodit të Shpërndarjes, Kodit të Matjes, për aq sa janë të zbatueshëm ndaj tij si dhe me të gjitha udhëzimet dhënë nga ZRRE-ja lidhur me Kodin e Shpërndarjes.
5. I Licencuari do të veproj në pajtim me Rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji që është nxjerrë nga ZRRE-ja.

## **Neni 5: Detyrimet e të Licencuarit Lidhur me Pajisjet Matëse**

1. I Licencuari, në përputhje me kërkesat sipas Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore, do të blejë aparaturat matëse prej konsumatorëve të tij që janë në pronësi të tyre.
2. Aty ku I Licencuari instalon ndonjë pajisje të re matëse, ai do të instalojë pajisjet matëse që i përkasin zgjedhjes së konsumatorit, në rast se tarifat e aprovuara i japin mundësinë konsumatorit të një grupi të caktuar, që të zgjedhin mënyrën dhe llojin e aparaturës matëse për regjistrimin e ngrohjes së konsumuar, në përputhje me dispozitat relevante të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore.

## **Neni 6: Kyçja në Rrjetin e Shpërndarjes së Ngrohjes**

1. I Licencuari do të kryejë operimin efikas, ekonomik dhe të koordinuar në sistemin e shpërndarjes;
2. Dispozitat e Nenit 11 në Ligjin mbi Energjinë, Nenet 45 deri në 48 dhe 52 në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore; kushtet për kyçje që jepen në Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe në Kodin e Shpërndarjes për ngrohje, do të jenë i aplikueshëm ndaj të Licencuarit.
3. I Licencuari si prioritet, do të lejojë kyçjen e gjeneratorëve të energjisë termike në Sistemin e Shpërndarjes së ngrohjes, dhe kyçjen e çdo prodhuesi të energjisë termike që bën gjenerimin prej burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe bashkë-gjenerimit, në përputhje me nenin 15.4 dhe 15.6 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore. Afatet dhe procedurat për kyçjen në Sistemin e Shpërndarjes së Ngrohjes do të rregullohen në Kodin e Shpërndarjes.
4. Të gjithë konsumatorët në zonat e mbuluara prej rrjetit të shpërndarjes së ngrohjes, kanë të drejtën të jenë të kyçur, nëse janë plotësuar kushtet e kyçjes së përshkruar në Kode, në përputhje me Nenin 23.2 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore.
5. Në rast se kontrata për furnizim komercial nuk është lidhur brenda periudhës së specifikuar në Nenin 32.5 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore për shkak të shkeljes së konsumatorit, siç specifikohet në Nenin 32.4 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore, shpërndarësi do të ndërpresë kyçjen e personit që merr ngrohje në mënyrë të paligjshme prej ndërmarrjes furnizuese, në përputhje me Nenin 32.6 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore.
6. Kyçjet ilegale dhe punët e paautorizuara në sistemin e ngrohjes, do t'i nënshtrohen akteve përkatëse shtesë, në përputhje me Nenin 23.5 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore.
7. Një konsumator që i shkakton dëm në pronën e të Licencuarit duke kryer kyçje të paligjshme dhe punë të paautorizuara, siç është përmendur më lart, do të jetë i detyruar të paguajë për dëmtimet e shkaktuara, në përputhje me Nenin 23.6 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore.
8. I Licencuari do të botojë dhe do të vërë në dispozicion në faqen elektronike zyrtare të vet, deklaratën për tarifat për kyçjen në sistemin e shpërndarjes së



ngrohjes e aprovuar prej ZRRE-së sipas Nenit 18 të Ligjit mbi Energjinë dhe Nenit 45 deri në 48 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.

### **Neni 7: Qasja dhe Shfrytëzimi i Rrjetit të Shpërndarjes së Ngrrohjes**

1. I licencuari do të lejojë që prodhuesit, furnizuesit dhe konsumatorët e privilegjuar të kenë qasje dhe shfrytëzojnë Rrjetin e Shpërndarjes së Ngrrohjes duke u bazuar në rregullat miratuara nga ZRRE-së dhe Ligjit mbi Ngrrohjen Qendrore.
2. I Licencuari mund të refuzojë qasjen në Rrjetin e Shpërndarjes së Ngrrohjes në përputhje me Nenin 28 të Ligjit mbi Ngrrohjen Qendrore.
3. Nëse nuk lejohet qasja në Rrjetin e Shpërndarjes së Ngrrohjes për konsumatorët e privilegjuar ose për prodhuesit që dëshirojnë të lidhin kontrata me Konsumatorë të Privilegjuar, atëherë Konsumatorët e Privilegjuar ose Prodhuesit e Energjisë Termike mund të aplikojnë në ZRRE për autorizim për ndërtimin e Gypit të Drejtpërdrejtë për Furnizimin me Ngrrohje, në përputhje me Nenin 29 Ligjit mbi Ngrrohjen Qendrore.
4. I Licencuari do të përgatisë çmimet dhe tarifat për shfrytëzimin e Rrjetit të Shpërndarjes së Ngrrohjes, t'i dorëzojë në ZRRE për aprovim dhe do t'i publikojë këto çmimet dhe tarifat të aprovuara në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Ngrrohjen Qendrore.

### **Neni 8: Plani Zhvillimor**

1. I Licencuari do bëjë studimin e zhvillimeve dhe kërkesave ekonomike dhe perspektivën e territorit përkatës dhe do të përgatisë për çdo vit plane afatshkurta dhe afatgjata për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes dhe ti koordinoj planet e tilla me Ministrinë e Energjisë dhe Minierave dhe me institucionet komunale përkatëse. Përmbajtja e studimeve të të Licencuarit si dhe planet afatshkurta dhe afatgjata do tu lehen në dispozicion ndërmarrjeve gjeneruese / shfrytëzuesve të rrjetit në përputhje me Nenin 15.3 të Ligjit për Ngrrohjen Qendrore.
2. Në Përputhje me Nenin 8 të Ligjit mbi Energjinë, Nenin 15.2 të Ligjit mbi Ngrrohjen Qendrore dhe Nenin 24.3 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, i Licencuari do të përgatisë dhe miratoj Planin Zhvillimor të Sistemit të Shpërndarjes për dy (2) vjetët vijues.
3. I Licencuari do të kontrollojë planin zhvillimor çdo vit në mënyrë që të sigurojë se informacionet e përcaktuara në planin zhvillimor, do të vazhdojnë të jenë të saktë në të gjithë aspektet materiale, dhe do ta dorëzojë për aprovim në ZRRE.
4. I Licencuari do ti asistojë Ministrisë për Energji dhe Miniera dhe autoriteteve përkatëse komunale në përgatitjen e planeve të tyre, programeve dhe strategjive zhvillimore, në përputhje me Nenin 15.3 të Ligjit për Ngrrohjen Qendrore.
5. I Licencuari do të jetë përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes si dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe vendndodhjes së tyre në përputhje me kërkesat teknika të përfshira në Kode si dhe nenin 15.2 të Ligjit për Ngrrohjen Qendrore. Zgjerimin dhe rindërtimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë termike që nga pika e shpërndarjes së energjisë termike e deri te

gjeneruesi i energjisë termike do të jetë përgjegjësi e shpërndarësit e sipas Nenit 15.5 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore.

### **Neni 9: Blerja Ekonomike e Aseteve dhe Shërbimeve**

- 1 I Licencuari do të kontraktojë ose do të bëjë marrëveshje për sigurimin e atyre asetëve dhe shërbimeve që janë të nevojshëm dhe të përshtatshëm për të mundësuar të Licencuarin kryerjen e detyrimeve sipas legjislacionit relevant mbi prokurimin publik, kësaj licence dhe Kodit të Shpërndarjes.
2. Në kontraktimin ose lidhjen e marrëveshjeve për sigurimin e asetëve dhe shërbimeve sipas paragrafit 1, i Licencuari do të blejë ose do të marrë në një formë tjetër ato asete dhe shërbime prej burimeve më ekonomike të mundshme të tij.
3. Burimeve më ekonomike të mundshme nënkupton që i Licencuari do të ketë parasysh sasinë, natyrën, llojllojshmërinë, numrin dhe kualitetin (sigurinë) e asetëve dhe shërbimeve në dispozicion në atë kohë për blerje, dhe sipas kërkesës ti bëjë të mundur që të kryej obligimet e tij sipas Legjislacionit, Kodit të Shpërndarjes dhe kësaj licence.

### **Neni 10: Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve Relevante**

1. I Licencuari do të përgatisë dhe do të mirëmbajë një regjistër për të gjithë asetet përkatëse dhe do t'ia japë ZRRE-së këtë regjistër çdo vit, jo më vonë se 31 Janar të atij viti.
- 2 I Licencuari nuk do ti tjetërsojë apo braktis kontrollin mbi cilindo aset të rëndësishëm po qe se tjetërsimi apo lënia pas dore e kontrollit do të ndikojë në aftësinë për ti kryer obligimet e tija, apo nëse aseti ka vlerën zëvendësuese mbi 100,000.00 Euro.
- 3 Në rast kur i Licencuari kërkon të tjetërsojë disa asete që janë pronë e tij ose të përdorura prej tij, si dhe burime të tjera të përdorura për të kryer aktivitetin e licencuar, është i detyruar të njoftojë me shkrim ZRRE-në. I Licencuari mund të realizojë tjetërsimin e ndonjë aseti vetëm pas aprovimit me shkrim nga ZRRE-ja.
- 4 E njëjta si në paragrafin 3 aplikohet ndaj dhënies për shfrytëzim të asetëve ose burimeve të tjera të shfrytëzuara për kryerjen e aktivitetit të licencuar.
5. Në këtë Nen:

**“Tjetërsimi”** nënkupton çdo shitje, transferim, dhurim, dhënie me qira, hua, hipotekë, ngarkim, kufizimin mbi shfrytëzimin (qoftë ky fizik ose ligjor), dhënie, ose ndonjë ngarkesë tjetër, si dhe lejimin e ndonjë ngarkese ndaj një Biznesi tjetër të të Licencuarit dhe/ose pale të tretë, dhe “tjetërsimi” do të interpretohet në përputhje me rrethanat.

**“Aset ”** konsiderohet:

- a) Çdo pajisje e sistemit të shpërndarjes që shfrytëzohet nga i Licencuari për të kryer funksionet e veta që përcaktohen nga kjo Licencë, ose
- b) Çdo interes ligjor ose përfitues mbi tokën dhe/ose ndërtesat në të cilat janë vendosur të sipërpërmendurit, dhe/ose që shfrytëzohet nga i Licencuari për të kryer funksionet e veta, ose
- c) Çdo e drejtë përkatëse mbi pronësinë intelektuale.

“*Tjetërsimi*” nënkupton çdo shitje, transferim, dhurim, dhënien me qira, hua, hipotekë, ngarkim, kufizimin mbi shfrytëzimin (qoftë ky fizik ose ligjor), dhënien, ose ndonjë ngarkesë tjetër, si dhe lejimin e ndonjë ngarkese ndaj një Biznesi tjetër të të Licencuarit dhe/ose pale të tretë, dhe “tjetërsimi” do të interpretohet në përputhje me rrethanat

### **Neni 11: Shfrytëzimi Shtesë ose Tjetërsimi e Aseteve Relevante**

1. Nëse ndonjë ose të gjithë asetet përkatëse janë duke u shfrytëzuar ose duke u tjetërsuar nga i Licencuari (ose ndonjë biznes i ndarë i të Licencuarit) për interesa të tjera ose përveç kryerjes së funksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, jo më vonë se tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Licence, i Licencuari do të njoftojë ZRRE-në në lidhje me këtë gjë dhe do t’i japë asaj informacionet që kjo e fundit mund të kërkojë në lidhje me këtë shfrytëzim ose tjetërsim.
2. Duke filluar prej datës së nxjerrjes së kësaj Licence, i Licencuari nuk do të bëjë shfrytëzim shtesë ose nuk do të tjetërsoj asnjë nga asetet përkatëse të përmendur në paragrafin 1, pa pasur aprovimin paraprak të ZRRE-së

### **Neni 12: Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit**

1. Jo më vonë se dymbëdhjetë (12) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj licence, i Licencuari duhet të krijojë Standardet për Sigurinë e Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit, dhe do ti dërgoi ZRRE-së për aprovim. ZRRE mund të shtyj këtë afat me kërkesën e arsyetuar të të Licencuarit.
2. I Licencuari do të jetë përgjegjës për vënien në funksion, sigurimin e mirëmbajtjes së Sistemit të Shpërndarjes, dhe nëse është e nevojshme, edhe zhvillimin e tij në përputhje me Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit si dhe me standarde të tjerë të planifikimit dhe operimit të cilat i Licencuari mund t’i miratojë kohë pas kohe, pas aprovimit të ZRRE-së.
3. I Licencuari do të shqyrtojë periodikisht Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe planifikimit dhe zbatimin e tyre. Pas këtij shqyrtimi, i Licencuari do të dërgojë në ZRRE për rishqyrtim dhe aprovim:
  - a) Një raport të rezultateve të këtij shqyrtimi; dhe
  - b) Revizionet që i janë propozuar të bëjë në Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit (duke pasur parasysh rezultatin e shqyrtimit).
4. ZRRE-ja mund të nxjerrë udhëzime që i kërkojnë të Licencuarit të rishikojë Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit, në atë

mënyrë që është specifikuar në udhëzim, dhe i Licencuari duhet të bjerë në pajtim më asi udhëzimesh.

5. I Licencuari do të publikojë dhe do t'i vërë Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit në dispozicion në faqen e tij elektronike zyrtare.
6. I Licencuari mund të kërkojë lirim nga detyrimet e veta sipas paragrafit 2, në lidhje me disa pjesë të Standardeve të Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit, dhe ZRRE-ja mund të nxjerrë udhëzime që e lirojnë të Licencuarin nga detyrimet e paragrafit 2 në lidhje me ato pjesë të standardeve të sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe planifikimit, në atë masë që specifikohet në udhëzime.

### **Neni 13: Standardet e Përbushjes së Biznesit të Operimit të Sistemit të Shpërndarjes**

1. I Licencuari do të drejtojë biznesin e operimit të sistemit të shpërndarjes në atë mënyrë që mendon në mënyrë të arsyeshme se është përlllogaritur në mënyrën më të mirë të mundshme për të arritur çdo apo të gjithë standardet dhe/ose synimet e përbushjes që mund të përcaktohen kohë pas kohe nga ZRRE-ja.
2. Brenda dymbëdhjetë (12) muajve nga nxjerrja e kësaj licence, i Licencuari do ta përgatisë dhe t'ia dorëzojë ZRRE-së për aprovim propozimin mbi standardet e përbushjes, të cilat do të:
  - a) identifikojë standardet e përbushjes së përgjithshme të cilat do të jetë i obliguar ti përbush;
  - b) paraqesë standardet minimale të përbushjes dhe kualitetin e shërbimeve në lidhje me çështjet specifike në të cilat do të jetë i obliguar të mbështetet kohë pas kohe; dhe
  - c) specifikojë kompensimet financiare që do tu paguhen konsumatorëve në rast kur standardet minimale nuk janë në përputhje me nën-paragrafin b).
3. ZRRE mund të miratoj shtyrjen e afatit të caktuar me paragrafin 2 si përgjigje në kërkesën e arsyetuar të të Licencuarit.
4. I Licencuari do të implementojë standardet e aprovuara dhe do t'i propozojë ZRRE-së për aprovim procedurat e monitorimit të pajtueshmërisë së të njëjtës. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me procedurat e aprovuara.
5. I Licencuari do të rishqyrtojë dhe, nëse duhet, do të propozojë ndryshimet në standardet e aprovuara, dhe/ose procedurat të realizuara në përputhje me këtë Nen sipas udhëzimeve të ZRRE-së.
6. I Licencuari do t'i sigurojë ZRRE-së jo më vonë se 31 Mars të çdo viti raport mbi ushtrimin e veprimtarisë lidhur me standardet e performimit. Ky raport do të përfshijë aso informatash dhe analizash nëse këtë e kërkon ZRRE-ja kohë pas kohe me qëllim që të vendosë, nëse i Licencuari has apo jo në përbushjet e përgjithshme, standardet e përbushjes sipas këtij Neni.

7. Gjatë kryerjes së funksioneve të veta, i Licencuari do të marrë parasysh synimin e të qenit objektiv dhe jo diskriminues.
8. I Licencuari, jo më vonë se 31 Mars të çdo viti do të publikoj në atë mënyrë që mund të udhëzojë ZRRE-ja, statistika që identifikojnë masën me të cilën puna e tij përmbush ose nuk arrin të përmbushë standardet e përmbushjes të përcaktuar sipas këtij Neni.

#### **Neni 14: Qasja në Tokë dhe /ose Ndërtesë**

1. Jo më vonë se tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Licence, i Licencuari do të përgatisë një Kod Pune ku përcaktohen parimet dhe procedurat që do të ndjekë në lidhje me ndonjë person që vepron në emër të vetin dhe që kërkon qasje në tokë dhe/ose ndërtesë lidhur me aktivitetin e licencuar, dhe do ta dorëzojë këtë Kod për aprovim nga ZRRE-ja.
2. Kodi i Punës do të përfshijë procedurat e përlllogaritura për të siguruar që personi që viziton tokën dhe/ose ndërtesën në emër të të Licencuarit:
  - a) Posedon aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat e kërkuara; dhe
  - b) Publiku mund t'i identifikojë me lehtësi;
  - c) Janë persona të përshtatshëm për të vizituar tokën dhe ndërtesat.
3. Me kërkesë të ZRRE-së, i Licencuari do të shqyrtojë periodikisht këtë Kod Pune dhe çdo ndryshim i këtij Kodi do t'i nënshtrohet aprovimit të ZRRE-së.
4. I Licencuari do të sigurojë që të veprojnë në pajtim me këtë Kod dhe me çdo ndryshim të tij siç aprovohet kohë pas kohe nga ZRRE-ja.

#### **Neni 15: Kufizimi në Përdorimin e Informacionit Përkatës**

1. I Licencuari mund të zbulojë çdo informacion përveç atij që është i fshehtë, dhe që mbahet dhe/ose është fituar gjatë kryerjes së funksioneve të veta si Operator i Sistemit të Shpërndarjes. Kjo ndalesë nuk do ta pengoj të Licencuarin që ti zbuloj informatat ZRRE-së që kjo mund ti kërkojë në kryerjen e obligimeve që i janë dhënë me Legjislacion dhe Nenin 26 të kësaj Licence.
2. I Licencuari do të sigurojë që çdo dokument që përmban informacione të fshehta, duhet ta bëjë identifikimin e qartë të informacionin si të fshehtë.
3. I Licencuari do të marrë masat e parapara për të parandaluar zbulimin e informacioneve të fshehta nga çdo person që është i punësuar apo ka pushuar të jetë i punësuar prej të Licencuarit.
4. I Licencuari do të marrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që informatat konfidenciale nuk do të përdoren apo zbulohen për ndonjë qëllim tjetër nga ajo që është dhënë dhe sipas dispozitave përkatëse të Rregullit për Informata Konfidenciale.

5. Në këtë Nen:

*”Informata konfidenciale (e fshehtë)”* është çdo informacion komercial ose tjetër dhe që mbahet dhe/ose është fituar nga i Licencuari gjatë kryerjes së detyrave të veta sipas Legjislacionit, dhe që do të konsiderohet si konfidenciale sipas Rregullit mbi Informata Konfidenciale dhe kësaj Licence.

#### **Neni 16: Sigurimi i Informacioneve për Operatorët e tjerë të Sistemit të Shpërndarjes**

1. Sipas dispozitave të Nenit 15, (Kufizimi në përdorimin e disa informacioneve), i Licencuari do të furnizojë Operatorët tjerë të Sistemit të Shpërndarjes, në atë formë dhe në atë kohë që mund të jetë kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga këta të fundit, për të siguruar funksionimin e sigurt dhe efikas, zhvillimin e koordinuar dhe ndër-funksionimin e sistemeve të ngrohjes qendrore
2. Për qëllimet e këtij Neni, në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje midis të Licencuarit dhe ndonjë pale tjetër, do të aplikohet Rregulli mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, që është nxjerrë nga ZRRE-ja

#### **Neni 17: Kodi i Sjelljes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes**

1. Brenda gjashtë (6) muajsh pas nxjerrjes së kësaj Licence, I Licencuari do të përgatisë Kodin e Sjelljes dhe dërgoi për aprovim ZRRE-së .
2. Kodi i Sjelljes do të aplikohet për të gjithë anëtarët e stafit të të Licencuarit.
3. Kodi i Sjelljes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes do ti mbulojë detyrimet lidhur me konfidencialitetin, konfliktet e interesave, dhe obligime tjera të ngjajshme.
4. I Licencuari do të publikoj Kodin e Sjelljes në faqen e tij elektronike.

#### **Neni 18: Shëndeti dhe Siguria**

1. I Licencuari do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të mbrojtur personat dhe pronat nga lëndimi dhe dëmtimi që mund të shkaktohet prej të Licencuarit ndërsa kryen Biznesin e Operatorit të Rrjetit të Shpërndarjes.
2. I Licencuari do të sigurojë që çdo vit të ndërmerret një kontroll teknik dhe i sigurisë për sa i përket Sistemit të Shpërndarjes, me anë të një eksperti të pavarur emërimi i të cilit aprovohet nga ZRRE-ja.
3. I Licencuari do t'i sigurojë ZRRE-së rezultatet e këtyre kontrolleve të kryera në kohën e caktuar.

#### **Neni 19: Puna**

I Licencuari do të bjerë në pajtim me të gjithë legjislacionin e aplikueshëm mbi marrëdhënie pune, qofshin ata në fuqi prej kësaj date, ose në të ardhmen.

## **Neni 20: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit**

I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll e të Licencuarit së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE-ja nuk e aprovon

## **Neni 21: Shërbimet Publike të Detyrueshme**

I Licencuari do të kryej çdo shërbim publik të detyrueshëm që mund të vendoset nga ZRRE-ja, sipas Nenit 51 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.

## **Neni 22: Sigurimi i Informacioneve ZRRE-së**

1. I Licencuari do të dorëzojë në ZRRE në formën dhe sa herë të kërkojë kjo e fundit, informacionin si dhe raportet që konsiderohen si të nevojshme sipas Neneve të kësaj Licence për qëllimet e kryerjes së funksioneve që i janë caktuar ose transferuar atij në përputhje me Nenin 29 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve Energjetike në Kosovë dhe legjislacionit tjetër të aplikueshëm.
2. Autoritetin e ZRRE-së për të kërkuar informatat nga paragrafi 1, nuk paragjykon autoritetin e ZRRE-së që të kërkojë informacione në përputhje me ose sipas ndonjë Neni tjetër të kësaj Licence ose në përputhje me legjislacionin.
3. Informacioni do të përgatitet në atë nivel të revizionimit që mund të kërkoher herë pas here nga ZRRE-ja.
4. Nëse i Licencuari kërkon që një informacion i caktuar të konsiderohet si konfidencial atëherë është obligim i tij që të shënoj atë informacion si konfidencial dhe të justifikoj kërkesën e tij tek ZRRE-ja.
5. I Licencuari do të dërgoj ZRRE-së raport tremujor dhe vjetore me të cilin informon mbi veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes e në përputhje me Doracakun e Raportimit të nxjerrur nga ZRRE-ja. Kjo do të përfshijë raportin vjetore mbi statusin e pajisjeve kryesore dhe përlogaritjen e vazhdimësisë së furnizimit dhe informata në kë raport mund të përfshijnë (pa kufizim):
  - a) Çmimet rritëse dhe zbritëse
  - b) Pagesat e kufizuara
  - c) Parashikimet e kërkesës
  - d) Detajet e konsumit
  - e) Profilet e Kërkesës së Sistemit
6. I licencuari do të dërgoj ZRRE-së detajet e çdo ndryshimi në informata që janë dërguar me aplikacionin për këtë licencë.
7. Në këtë Nen:

**"Informacion"** është material në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, kontabilitet, llogaritje (statusore ose tjetër),

vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga ZRRE-ja.

### **Neni 23: Arsyet për Përfundimin, Tërheqjen dhe Modifikimin e Licencës**

1. ZRRE-ja mund të përfundojë këtë licencë në përputhje me Nenin 39 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, në rast të:
  - a) Skadimit të afatit të licencës;
  - b) Me kërkesë të ndërmarrjes së licencuar të ngrohjes lidhur me licencën e tij;
  - c) shpërbërjen e personit ligjor që mban licencën;
  - d) Me vendim të gjykatës që deklaron falimentimin e të licencuarit, ose me anë të vendimit të gjykatës për të përfunduar aktivitetin e furnizimit me energji për shkak të deklaratës së të licencuarit rreth falimentimit të tij;
  - e) Nëse aktiviteti i licencuar i energjisë termike nuk është drejtuar për më shumë se gjashtë muaj, përveç në rast kur pezullimi i aktivitetit është kryer me miratim të ZRRE-së;
  - f) Nëse janë përmbushur dispozitat e Nenit 44 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
  - g) Si dhe, në se shuma e taksës që duhet paguar për këtë licencë nuk është paguar për tridhjetë (30) ditë pasi është dashur të paguhet, dhe mbetet e papaguar për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh të tjera pasi të Licencuarit i është dërguar njoftimi me shkrim nga ZRRE-ja se pagesës i ka kaluar afati.
  
2. ZRRE-ja mund të tërheqë këtë licencë në rastet vijuese, siç përcaktohet në Nenin 44.5 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve Energjetike në Kosovë, me kusht që detyrimet e të licencuarit të kryhen nga një i licencuar tjetër, ose që konsumatorët të mos jenë në disavantazh nga kjo tërheqje:
  - a) i licencuari nuk arrin të plotësojë ose shkel kushtet materiale ose detyrimet e licencës dhe këto të fundit nuk janë ndrequr brenda afatit përfundimtar të dhënë nga ZRRE-ja, ose kanë dëmtuar seriozisht cilësinë, sigurinë dhe seriozitetin e shërbimit që i Licencuari ka qenë i detyruar të sigurojë;
  - b) monitorimi i licencës nga ZRRE-ja ose Inspektorati gjen dështim në përmbushjen e kriterëve administrative, dhe ky dështim nuk është ndrequr brenda afatit përfundimtar të dhënë nga ZRRE-ja;
  - c) i licencuari ka paraqitur informacione të rreme mbi të cilat është bazuar dhënia e licencës.
  
3. Në përputhje me Nenin 35 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ZRRE-ja mund të modifikojë licencën në rastet në vijim:
  - a) Me kërkesë të të Licencuarit;
  - b) Nëse nevojitet për të mbrojtur sistemin e ngrohjes në Kosovë, në lidhje me sigurinë e furnizimit ose sigurinë e jetës dhe shëndetit të qytetarëve, ose në lidhje me mbrojtjen e mjedisit.
  - c) Në mënyrë që të përshtatet me kritere të reja që janë përcaktuar në marrëveshjet ndërkombëtare dhe ligjet vendore, rregulloret , si dhe në legjislacione të tjera të aplikueshme;
  - d) Si sanksion për shkeljen dhe kushteve dhe termave të licencës, sipas nenit 44 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.



## **Neni 24: Masat Administrative dhe Gjobat**

1. Në rast të shkeljes së ndonjë dispozite të legjislacionit dhe të ndonjë Neni të kësaj licence si dhe ndonjë udhëzimi që ZRRE-ja i ka dhënë të licencuarit, ZRRE-ja ka autoritet që sipas Nenit 56.2 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullit mbi Masat dhe Gjobat Administrative ose të parandalojë të licencuarin që të përsërisë veprimin e paligjshëm, ose në rast se veprimi është ndalur, të nxjerrë një vendim rregullativ ku kërkohet që të ndërmerret një veprim i caktuar ose të vendosen gjoba administrative ndaj të Licencuarit dhe/ose anëtarëve të Bordit të tij të Drejtorëve dhe/ose zbatuesve të tij.
2. Para se të jepet gjoba ZRRE do ti lëshoj të licencuarit një njoftim mbi shkeljet e bëra dhe do ti ofroj mundësi që brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga data e pranimit të njoftimit të përgjigjet ZRRE-së me shkrim për të përmirësuar shkeljen.
3. Gjoba do ti ngarkohet të Licencuarit në pajtim me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullin për Masat Administrative dhe Gjobat nëse i Licencuari shkel dispozitat e ati Neni derisa ato janë të aplikueshme për të Licencuarin.
4. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Rregullin për Gjobat dhe Masat Administrative. Sidoqoftë nëse gjoba nga paragrafi 3 i ngarkohet të Licencuarit ajo nuk mund ta tejkaloj 15% e bruto të ardhurat e të Licencuarit nga veprimtaria e ushtruar sipas kësaj licence në vitin financiar paraprak.
5. Nëse gjoba nga paragrafi 3 i është ngarkuar anëtarit të Bordit të Drejtorëve apo ekzekutivit të të Licencuarit ajo nuk duhet të tejkaloj 300% e pagës mujore që ai person ka pranuar nga i Licencuari.
6. Në rast të shkeljeve të përsëritura, gjoba e vendosur mund të jetë 3 herë më e madhe se shuma e autorizuar në paragrafët 4 ose 5.
7. Në përputhje me këtë Nen, kur ZRRE-ja vendos një gjobë, duhet të marrë parasysh shkallën e dëmit social të veprimit, sjelljen e mëparshme të të Licencuarit apo personit në fjalë si dhe situatën financiare të të Licencuarit apo personit në fjalë.
8. Nëse gjoba e vendosur nga ZRRE-ja nuk paguhet, ZRRE-ja do të fillojë procedurat gjyqësore për mbledhjen e gjobës si borxh civil.

## **Neni 25: Zgjidhja e Kontesteve**

1. Çdo mosmarrëveshje që lind për shkak të aktivitetit të licencuar, do të zgjidhet në përputhje me Rregullin mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, që është nxjerrë nga ZRRE-ja.
2. Vendimet e ZRRE-së në lidhje me modifikimin, tërheqjen ose përfundimin e licencës, si dhe ato që kanë të bëjnë me gjobat që pasojnë nga shkeljet e licencës

ose të legjislacionit të aplikueshëm, mund të apelohej nga i Licencuari në gjykatën kompetente.